



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202201482/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e të drejtave themelore kushtetuese të shtetasit G.Sh., mosmbajtjen e tij të prangosur në kushte spitalore, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tyre.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë konform nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, rastin e bërë publik në disa media vizive dhe të shkruara në datën 07.12.2022 e në vijim, mbi pamjet filmike dhe fotot e dhunuesit të z. Sali Berisha në datën 06.12.2022, shtetasit G.Sh. në ambientet e Spitalit të Traumës Tiranë¹. Ky shtetas shfaqet me pranga në duar, i enjtur dhe i shtrirë në një krevat në ambientet e spitalit ku po merr trajtim mjekësor pas dëmtimeve të pësuar datën e incidentit kur ai sulmoi fizikisht z. Berisha.

¹ https://www.google.com/url?sa=i&url=https%3A%2F%2Feuronews.al%2Ffoto-momenti-kur-gert-shehu-mberriti-ne-spital%2F&psig=AOvVaw2Xs4x88R3eDjD7ZItgXVDN&ust=1671035355133000&source=images&cd=vfe&ved=0CA4QjhxqFwoTCliVn4-C9_sCFQAAAAAdAAAAABAE

Gjithashtu nga media² është transmetuar edhe momenti kur shtetasi G.Sh. nënshkruan një dokument të përpiluar nga punonjësit e Policisë së Shtetit të cilët janë të pranishëm. Edhe në momentin e nënshkrimit të këtij dokumenti, shtetasi G.Sh. është me pranga në dorën e djathtë me të cilën firmos dokumentin e dhënë atij nga punonjësit e policisë. Këto pamje filmike dhe fotografike provojnë faktin e pakundërshtueshëm se i arrestuari G.Sh. mbahet i lidhur me pranga në mënyrë të vazhdueshme në Spitalin e Traumës ku ndodhet duke marrë ndihmë mjekësore dhe me shumë mundësi i lidhur në krevatin në të cilin ndodhet i shtrirë.

Është rasti të theksojmë se Avokati i Popullit e dënon ashpër sulmin e kryer nga shtetasi G.Sh. ndaj z. Sali Berisha. Gjatë veprimtarisë së tij institucioni ynë në mënyrë të vijueshme ka shprehur qëndrime publike kundër çdo lloj forme të dhunës fizike apo psikologjike si nga punonjësit e institucioneve shtetërore ndaj qytetarëve, ashtu edhe nga shtetas të ndryshëm ndaj përfaqësuesve të strukturave shtetërore dhe atyre politike. Në të gjitha rastet vlerësojmë ndëshkimin ligjor të të gjithë personave që kryejnë këto akte të kundërligjshme.

Por, ndërkohë nga shqyrtimi i këtij rasti të bërë publik në media, Avokati i Popullit, pavarësisht pozitës ligjore në të cilën gjendet shtetasi i arrestuar G.Sh., e gjen me vend të sjellë në vëmendje dhe të analizojë një fenomen negativ që cënon rëndë të drejtat themelore të individëve sikurse është ai i mbajtjes lidhur me pranga të personave të ndaluar/arrestuar apo dënuar në kushte spitalore.

Nga studimi i kuadrit ligjor në fuqi, konstatojmë se procedura e mbajtjes të prangosur të personave të arrestuar apo ndaluar nga policia e shtetit në kushte spitalore, nuk është e bazuar në aktet normative në fuqi. Edhe më parë ky shqetësim është trajtuar nga ana jonë. Një procedurë e tillë ka qenë e parashikuar shprehimisht në Manualin “Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore” miratuar me Urdhrin nr. 64 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në Kreun e VII, paragrafi 5, të këtij manuali parashikoheshin rregullat e sigurisë gjatë trajtimit të personave të ndaluar dhe arrestuar në qendrat spitalore. Pika 2 e këtij paragrafi parashikonte se: *“Në rast se qendra spitalore nuk ofron ambiente të veçanta izolimi për këtë kategori individësh, personat e arrestuar ose ndaluar mbahen të lidhur me pranga në njërin dorë pas krevatit të fjetjes”*.

Gjatë trajtimit të një rasti të tillë të ngjashëm në vitin 2011, Avokati i Popullit konstatoi se dispozita e mësipërme ishte haptazi në kundërshtim të plotë me aktet normative në fuqi dhe me standardet e trajtimit të personave të arrestuar, të ndaluar dhe të dënuar.

² Për më tepër:

<https://www.vizionplus.tv/i-enjtur-dhe-me-pranga-ne-duar-del-foto-e-gert-shehut-nga-spitali-i-traumes-berisha-pritet-te-thirret-sot-ne-polici/>

Referuar nenit 17 të Kushtetutës tonë, *kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jenë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuar në KEDNJ.*

Sipas nenit 28/5 të Kushtetutës, *çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27 ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.*

Ndërsa në nenin 25 të Kushtetutës është parashikuar se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”.*

Për këto arsye, në vitin 2011 Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shfuqizimin e pikës 2, të paragrafit 5, të Manualit “Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore” miratuar me Urdhrin nr. 64 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Rekomandimi u pranua dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me Urdhrin nr. 736, datë 27.09.2011 miratoi Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”. Në kreun e VII të tij, pika 5.2 parashikohej se: *“Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shitesë për ruajtjen dhe sigurimin e të arrestuarit/ndaluarit. Këto masa planifikohen dhe zbatohen në varësi dhe në proporcionalitet me shkallën e rrezikshmërisë që paraqet personi, precedentët penalë që ka, gjendjes shëndetësore, shkallën e dëmtimeve fizike të tij, kohën e qëndrimit të tij për trajtim mjekësor, etj”.*

Por edhe në Procedurën standarde aktuale me titull: **“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”**, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07. 2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në Kapitullin X “Rregullat dhe masat e sigurisë gjatë veprimeve me të ndaluarin/arrestuarin, jashtë dhomave të sigurisë”, pika 5 “Rregullat e sigurisë gjatë trajtimit në qendrat spitalore”, parashikohet se:

5.1 Trajtimi i të ndaluarve e arrestuarve në qendrat rajonale spitalore, bëhet në dhoma/ambiente të veçanta të tyre të cilat duhet të plotësojnë këto kushte sigurie:

- a) Të ketë ndarje të dhomës me zgarë hekuri në dhomë dhe paradhomë.*
- b) Dritaret të jenë të siguruara me zgarë hekuri me shufra me seksion jo më pak se 16 – 18 mm, e me kuadrate 15 x15 cm.*
- c) Dera që ndan dhomën me paradhomën të mbyllet me bravë apo dry.*
- d) Tuelalet për kryerjen e nevojave të jetë brenda në dhomë dhe në pamundësi të ketë dritare të siguruar si dritarja e dhomës.*

5.2 Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shitesë për ruajtjen e sigurimin e të

arrestuarit/ndaluarit. Këto masa planifikohen dhe zbatohen në varësi dhe në proporcionalitet me shkallën e rrezikshmërisë që paraqet personi, precedentët penale që ka, gjendjes shëndetësore, shkallën e dëmtimeve fizike të tij, kohëzgjatjen e qëndrimit të tij për trajtim mjekësor, ambientin ku do të mbahet e trajtohet, etj.

5.3 Shërbimi për sigurimin e të ndaluarve/arrestuarve në institucionet mjekësore kryhet me jo më pak se dy punonjës policie, njëri prej të cilëve qëndron brenda në dhomë.

5.4 Dera që ndan paradhomën nga dhoma qëndron gjithmonë e mbyllur dhe çelësi mbahet nga punonjësi i policisë që qëndron në korridor apo paradhomën e ambientit.

5.5 Punonjësi i policisë i cili qëndron në paradhomë ose korridor, kryen shërbimin me armatim personal (automatik dhe pistoletë), ndërsa punonjësi i policisë që qëndron në ambientin e qëndrimit të arrestuarit/ndaluarit nuk mban asnjë lloj armatimi.

5.6 Nxjerrja e të arrestuarit/ndaluarit jashtë dhomës për në tualet apo ambiente të tjera të spitalit, bëhet i lidhur me pranga në duar përpara dhe i shoqëruar nga dy punonjës të policisë. Njëri e mban të kapur nga krahu dhe tjetri e shoqëron nga pas me armë.

5.7 Në varësi të rrezikshmërisë që paraqet, gjendjes shëndetësore dhe ambienteve ku do të kryen ekzaminime të tjera mjekësore përcaktohen e zbatohen masa shtesë për ruajtjen dhe sigurimin e tij duke shtuar numrin e punonjësve të policisë.

Pra, si në Manualin e miratuar në vitin 2011 dhe në Procedurën standarde aktuale me titull: **“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”**, e cila është në fuqi, nuk parashikohet në asnjë rast e drejta e policisë për të mbajtur të lidhur me pranga në njërin dorë pas krevatit të fjetjes personin e arrestuar ose ndaluar që ndodhet për trajtim mjekësor në qendrat spitalore. Parashikimi në Procedurën aktuale i shprehjes se, “Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shtesë për ruajtjen e sigurimin e të arrestuarit/ndaluarit”, nuk do të thotë që i arrestuari/ndaluari gjatë qëndrimit në qendrën spitalore për trajtim mjekësor të mbahet i lidhur me pranga në duar apo të lidhet me pranga pas krevatit, sikurse është vepruar në këtë rast nga punonjësi i policisë ndaj shtetasit të arrestuar G.Sh.. Ky parashikim përcakton që në këto raste nga drejtuesit duhet të shtohet numri i punonjësve të policisë që do të bëjnë ruajtjen dhe sigurimin e të arrestuarit ose të ndaluarit të shtruar në qendrën spitalore.

Ne vlerësojmë se, mbajtja e lidhur me pranga të shtetasit të arrestuar G.Sh. është një veprim që përbën trajtim çnjerëzor.

Përfundimi i mësipërm gjen pasqyrim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në vijimësi në praktikën e saj ka trajtuar problemin e përdorimit të prangave ndaj të arrestuarve në ambientet spitalore. Kështu, në Çështjen *Mouisel kundër Francës*, Aplikimi nr. 67263/01 datë 14 Nëntor 2002 dhe në Çështjen *Henaf kundër*

Francës, Aplikimi nr. 65436/01 datë 27 Nëntor 2003, Gjykata shprehet se, mbajtja e personave të prangosur në kushte spitalore nuk justifikon gjithmonë qëllimet e sigurisë ndaj tyre. Akte të tilla janë konsideruar shpesh si jo humane dhe degraduese, veçanërisht për persona me një gjendje të rëndë shëndetësore, si dhe bien në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ. Konkretisht, në rastin e përmendur më sipër, Mouisel kundër Francës, Gjykata ka vendosur që, në rastin konkret dhe të veçantë të paditësit, përdorimi i prangave mund të përbënte një trajtim degradues. Mouisel ka argumentuar se metoda e transferimit nga burgu në klinikën e specializuar, ka sjellë si rrjedhojë një trajtim çnjerëzor dhe degradues, duke kërkuar kështu zbatimin e nenit 3.

Ndërsa, në Çështjen Istratii dhe të tjerët kundër Moldavisë, 27 mars 2007, nr. 8721/05, 8705/05 dhe 8742/05 Gjykata u shpreh se, fakti që ankuesi ishte prangosur në një radiator të spitalit, në pritje për të bërë operacionin, përbën shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Në Çështjen Koutcherouk kundër Ukrainës, nr. 2570/04 të datës 6 Shtator 2007, GJEDNJ arriti në përfundimin që, ka shkelje të nenit 3 të KEDNJ, për shkak të mbajtjes së të pandehurit (i sëmurë me skizofreni) me duar të lidhura me pranga për 7 ditë, nga 9 ditët gjatë të cilave ka qënë në qeli izolimi.

Po ashtu, vlen të përmenden Çështjet Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2 tetor 1998, § 93; Selmouni kundër Francës, 28 korrik, § 1999, § 95, Dakratas kundër Lituanisë, 10 tetor 2000, § 32; Labita kundër Italisë, 4 Prill 2000; Indelicato kundër Italisë, 18 tetor 2001. Në të gjitha rastet, Gjykata ka theksuar se, neni 3 përmban një garanci absolute, madje edhe në rastet më të vështira sikurse në luftën kundër terrorizmit ose krimin të organizuar dhe kjo është një e drejtë e domosdoshme, që nuk parashikon as kufizime as derogime, ndryshe nga sa ndodh me dispozitat e tjera të Konventës.

Gjykata e Strasburgut ka përsëritur herë pas here në vendimet e saj se: “Shqyrtimi i nenit 3 duhet të jetë veçanërisht i plotë dhe se duhet të ketë vëmendje maksimale në çështjet që kanë të bëjnë me të drejta të tilla si ato të përcaktuara në këtë nen të Konventës. (Çështja Ribitsch kundër Austrisë, 4 Dhjetor 1995, FQ 20 § 32). Neni 3 i KEDNJ ndalon në mënyrë absolute torturën, trajtimin ose ndëshkimin jo-njerëzor ose degradues pavarësisht nga sjellja e viktimës. Ai përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Natyra e krimin të kryer është e parëndësishme për sa i përket shqyrtimit të çështjes në bazë të këtij neni” (Çështja V. e T. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 Dhjetor 1999, fq 25, § 67).

Për pasojë të këtij veprimi, në të tilla raste, shteteve të përfshira në këto procese iu janë caktuar detyrime financiare për shkelje të nenit 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Madje shpesh nëpërmjet këtyre vendimeve shtetet palë kanë marrë masa për të rishikuar kuadrin ligjor kombëtar duke caktuar standarde të pranueshme dhe të arsyeshme të sigurisë ndaj personit.

Gjithashtu sjellim në vëmendje se edhe Komiteti i Parandalimit të Torturës (KPT) të Këshillit të Europës është shprehur se praktika e mbajtjes së prangosur në spital e personave të burgosur është një akt degradues ndaj individëve dhe duhet zëvendësuar me masa të tjera alternative sigurie. Në mënyrë të qartë një qëndrim i tillë është mbajtur në Raportin e Dytë të Përgjithshëm të KPT-së (CPT/inf (92)3), ku midis të tjerash thuhet se: *“Të burgosurit e dërguar në spital për t`u trajtuar nuk duhet të lidhen fizikisht në shtretërit e tyre të spitalit ose në pajisje të tjera për arsye ruajtjeje. Mundet dhe duhet të gjenden mjete të tjera që të plotësojnë kënaqshëm nevojat e sigurisë”*. Ky qëndrim ka ardhur si rezultat i shumë konstatimeve të këtij Komiteti gjatë vizitave në vendet anëtare të Këshillit të Europës, ku objekt ka qenë trajtimi i personave të kufizuar nga liria.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti vlerësojmë se, shtetasit të arrestuar G.Sh. i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga nenet 25 dhe 28/5 të Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *për të mos iu nënshtruar torturës ose dënimit ose trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës*.

Ne çmojmë se punonjësit e Policisë së Shtetit, si ata që kishin për detyrë ruajtjen dhe sigurimin e të arrestuarit G.Sh., ashtu edhe drejtuesit e tyre që nëpërmjet dhënies së urdhrave (detyrave) në funksionin e eprorit punonjësve të policisë për ta mbajtur lidhur atë me pranga gjatë trajtimit mjekësor në Spitalin e Traumës, e kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore atë.

Nga ana tjetër, evidentojmë se veprime të tilla të punonjësve të policisë duke shkelur në mënyrë të hapur të drejtat kushtetuese e ligjore të shtetasve të arrestuar/ndaluar të garantuara nga aktet normative ligjore e nënligjore në fuqi janë të përsëritura. Pavarësisht se nga Avokati i Popullit për këtë problematikë janë bërë rekomandime, të cilat janë pranuar dhe si rezultat i masave të marra në zbatim të tyre është ndryshuar edhe akti nënligjor, Manuali për trajtimin e të arrestuarve³, me keqardhje konstatojmë se praktika e paligjshmërisë ende vijon. Rasti në fjalë nuk duhet të kalojë në heshtje nga strukturat drejtuese vendore e qendrore të Policisë së Shtetit dhe se prej tyre duhet të ketë një reagim të fortë dhe analizë objektive. Sjellim në vëmendje se veprime të tilla të kryera nga punonjës të veçantë të Policisë së Shtetit sjellin si pasojë dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të këtij organi si dhe humbjen e besimit publik, të cilat janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të misionit ligjor për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; nenin 21/b e c të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime: b) për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; c) për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka*

³ Manuali “Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore”, miratuar me Urdhrin nr. 64 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

shkaktuar shkeljen”; si dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga “Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9094 datë 03.07.2003,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e trajtimit njerëzor dhe jo degradues të shtetasit të arrestuar G.Sh., duke i hequr prangat dhe mos mbajtjen e tij të lidhur gjatë trajtimit mjekësor në Spitalin e Traumës, Tiranë.
2. Analizimin e thellë e me objektivitet të këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për njohjen e punonjësve të Policisë së Shtetit me Procedurën standarde me titull: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07. 2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore e qendrore të Policisë së Shtetit me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen raste të tilla të shkeljes së të drejtave themelore të shtetasve nga ana e punonjësve të këtij organi.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi